

E nderuar kryetare e ASHAK, Akademike Justina Shiroka Pula
E nderuara familje Daci, Zonja Zineta, vajzat Edi dhe Majlinda
Të nderuar anëtarë të Akademisë, kolegë dhe miq, të nderuar pjesmarrës
Zonja dhe zotërinj

Lajmi pikellues për vdekjen e Akademik Nexhat Daci na ka tronditur thellë, të gjithë neve anëtarëve të Akademisë së shkencave dhe Arteve të Kosovës, punëtorëve administrativ dhe teknik.

Nexhat Daci u lind në vitin 1944 në Tërrnoc të Bujanocit. Shkollimin fillor e kreu në vendlindje, ndërsa atë të mesmin e përfundoi në Leskoc në vitin 1960. Studimet e rregullta për lëmin e kimisë i kreu në FSHMN të UB në vitin 1966. Në këtë universitet i mbaroi edhe studimet pas-universitare në vitin 1968 dhe e mori gradën magjistër i kimisë. Studimet e doktoratës i kreu në Fakultetin e Teknologjisë të Universitetit të Zagrebit, gjatë periudhës 1970-1973 me temën e doktoratës me titull “Kontribut në përcaktimin e strukturës kimike të substancës organike të thëngjillit të Kosovës”. Atë e mbrojti në vitin 1973 në moshën 29 vjeqare dhe mori gradën doktor i shkencave të kimisë.

Në vitin 1966 Nexhat Daci zgjidhet asistent në Seksionin e kimisë të Fakultetit filozofik. Në vitin 1970 zgjedhet ligjërues i kimisë. Në vitet 1971-1973 ishte shef i degës së Kimisë. Në këto vite ka kontribuar shumë edhe për hapjen e fakultetit të Mjekësisë dhe atij të Bujqësisë në kuadër të UP.

Specializoj në disa qendra studimore të botës. Kështu, një kurs pasuniversitar e kreu në Liege të Belgjikës në vitin 1970, kurse studimet e pasdoktoratës i vazhdoi në Angli, në Universitetin e Bradford-it në vitin 1974.

Në vitin 1974 zgjedhet profesor inordinar ndërsa në vitin 1984 zgjedhet profesor ordinar i Fakultetit të Shkencave Matematiko Natyrore të UP.

Kontribut të theksuar prof. Daci ka dhënë në vendosjen e bashkëpunimit me profesorët nga Shqipëria duke filluar prej akad. Kolë Popës dhe profesorëve tjerë të shkencave të natyrës në përgjithësi dhe të Kimisë në veçanti. Përveq mësimdhënies në FSHMN me studentët e kimisë, ai gjithashtu me dekada ka mbajtur ligjerata në lëndën e kimisë edhe në fakultetin e Mjekësisë të UP. Ai po ashtu ka dhënë kontribut të theksuar në ngritjen akademike në udhëheqjen e punimeve të magistraturës dhe të doktoratës. Disa nga kolegët i ka rekomanduar në qendrat tjera për studime pasdiplomike. Ka qenë udhëheqës i disa punimeve të doktoratës në cilësinë e mentorit edhe në Universitetin e Zagrebit.

Ai gjithashtu e ka motivuar kuadrin e ri të merr pjesë aktive në punën kërkimore shkencore dhe ka nxitur pjesëmarrjen e tyre në forumet kombëtare dhe ndërkombëtare të shkencës. Analizën dhe krahasimin e rezultateve në shkencë akad. Daci e ka bërë çdo herë duke iu referuar burimeve më relevante në shkencë përmes revistave që janë botuar në platformat kryesore në botë. Këtë qasje e ka kultivuar për dekada dhe tani ajo është bërë po thuajse normë në Departamentin e Kimisë të Fakultetit të Shkencave Matematiko-Natyrore.

Në vitin 1987 u zgjodh anëtar i Akademisë Europiane për çështje të mjedisit. Në vitin 1993 u zgjodh anëtar korrespondent i ASHAK, ndërsa në vitin 1996 u zgjodh anëtar i rregullt, dhe më pas është zgjedhur sekretar i përgjithshëm i saj. Ishte nismëtar dhe organizator i sigurimit të ndihmave për funksionim të Akademisë në periudhën kur vendi ishte në rrethanat e jashtëzakonshme.

Gjatë periudhës 1999-2002 dhe asaj 2018-2019 është zgjedhur kryetar i ASHAK-ut. Në vitin 2014 u zgjodh anëtar i Akademisë Europiane të Shkencave dhe të Arteve, AESA, me seli në Salzburg të Austrisë.

Në vitin 2015 u zgjodh anëtar i përhershëm i komitetit të ALLEAS (Federata e Akademisë Kombëtare të Shkencave të Europës) për projekte shkencore.

Në vitin 2022 u zgjodh anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë.

Akademik Daci ishte anëtar i disa institucioneve dhe asociacioneve ndërkombëtare, ndër të cilat edhe i Shoqatës së Kimistëve Amerikan nga vitit 1985

Veprimtaria e tij shkencore përmban punime shkencore të publikuara në revista të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, projekte shkencore, elaborate, kumtesa dhe tekste universitare.

Është autor dhe bashkëautor i 95 punimeve shkencore disa nga të cilat janë botuar në revistat shkencore të indeksuara në platformat kryesore shkencore. Veçohen punimet shkencore të përcaktimit të strukturës së substancës organike të qymyrit të Kosovës, pastaj të përbërësve inorganik të qymyrit, të analizave të ndryshme të hirit nga termocentralet dhe punime shkencore nga fusha e mbrojtjes së mjedisit.

Ai është pjesëmarrës me kumtesa në shumë tubime shkencore, si në SHBA, në Angli, Gjermani, Itali, Turqi, Hungari, Slloveni, Kroaci, dhe Shqipëri.

Ka udhëhequr ose ka marr pjesë si anëtar ekipi në 15 projekte shkencore nga fusha e kimisë dhe ajo e mjedisit. Në fushën e kimisë janë të rëndësishme projektet: Hulumtimi i substancës së thëngjillit dhe mundësia e përfitimit të karburantëve të pastër dhe të plehërave kimike organike (1979-1982), projekti për kualitetin dhe përbërësit e boksiteve të Kosovës (1985-1986), dhe ai i veshjes së sipërfaqes së qymyrit me shtresa të holla organike (2019-2021).

Në fushën e mjedisit veçohen projektet: Furnizimi i Kosovës me ujë të pijes dhe hulumtimi i ujërave të ndotura (1973-1975), Studimi i mundësisë së pastrimit të ujërave të ndotura të industrisë së Kosovës (1983-1985), Përcjellja e ndryshimit të kualitetit të ujit të akumulimit të liqenit “Batllava” (1982-1983) dhe atij të Radoniqit (1982-1985).

Akademik Daci udhëhoqi edhe projektin shkencor të ASHAK “Identifikimi i ndotësve të efluentëve të ujërave urbane dhe të industrisë dhe trajtimi i tyre” (2012-2014) si dhe atë të kadastrit të ndotësve të ujërave efluent dhe trajtimi i tyre (2016-2018).

Akademik Nexhat Daci është autor ose bashkëautor i 7 teksteve universitare dhe i po aq teksteve shkollore.

Libri i tij universitar “Kimia Organike” i botuar në vitin 1981 për studentët e Kimisë të Universitetit të Prishtinës është vlerësuar me çmimin “Naim Frashëri”. Ky libër është ribotuar edhe 5 herë dhe i njëjti edhe aktualisht është libër bazë për studentët e kimisë në Kosovë dhe në Shqipëri.

Në ASHAK po ashtu i ka botuar librat: “Kimia organike eksperimentale”, “Kimia e Mjedisit, Ndotja industriale – Parandalimi” si dhe “Shkenca e Mjedisit-Zhvillim i Qëndrueshëm,”

Ka kenë bashkë autor edhe i dy kapitujve të librave që janë botuar në vitin 1985 dhe 1987 nga botues ndërkombëtar.

Akad. Nexhat Daci ka dhënë kontribut të çmuar edhe në përfaqësimin e ASHAK-ut në kuadër të 4 konferencave për Ballkanin perëndimor të organizuara prej Akademisë Gjermane e Shkencave Leopoldina në Berlin, Vjenë, Paris dhe Romë gjatë viteve 2015-2018.

Nexhat Daci ka qenë shumë aktiv në jetën politike dhe institucionale të Kosovës: në periudhën 2001-2014 ishte deputet i Kuvendit të Kosovës ndërsa në vitet 2001-2006 ishte kryetar i Kuvendit të Kosovës. Gjatë kohës sa ishte kryetar i Kuvendit të Kosovës, akademik Daci ka luajtur rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e jetës institucionale të Kosovës sepse në dy legjislatura me angazhimin e drejtperdrejt të tij është arritur të bëhet marrëveshja e partive politike për të qeverisur vendin. Ky stabilitet institucional e ka lehtësuar përgatitjen e Kosovës për shpalljen e pavarësisë në vitin 2008. Në vitin 2007 e themeloi partinë politike LDD dhe u bë kryetar i saj.

Me plot të drejtë mund të thuhet se ai përveq se ishte korifeu i Kimisë në Kosovë, ai me përkushtimin e vazhdueshëm ndaj kauzës kombëtare po ashtu ishte edhe figurë kyçe e shtetndërtimit të Kosovës.

Akademik Nexhat Daci në kohë dhe hapësirë më së miri diji dhe pati sukses të plotë ta ndërtojë projektin e nevojave të shoqërisë kosovare në sferën e hulumtimeve shkencore, të arsimit dhe edukimit. Ai u shëndrrua në një nga figurat emblematike të arsimit të lartë dhe shkencës në Kosovë. Ai edhe kur ishte pjesë e pushtetit në instancat më të larta të tij, asnjëherë nuk është shkëputur nga njeriu i vendit tonë dhe nuk është ndarë nga qëllimi i tij për përparimin vendit.

Populli ynë e ka një fjalë të urtë e të lashtë: “Nuk vdes ai që me dhe mbulohet por vdes ai që shpejt harrohet”. Akademik Daci me punën e vet produktive, me brezat e studentëve dhe me një familje të mrekullueshme që e ka lënë pas e ka siguruar se do të mbetet përgjithmonë i paharrueshëm në opinionin shkencor e arsimor të Kosovës.

Familjes, farefisit dhe anëtarëve të ASHAK, ju shprehim edhe një herë ngushllimet më të sinqerta!

Ju faleminderit

Akademik Fejzullah Krasniqi